



**Informim javor për median  
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°30/2022

Hagë, 25/08/2022

**Përditësim**

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të drejtuar pyetje.

Në çështjen gjyqësore *Hashim Thaçi dhe të bashkakuzuarit*, Paneli i Gjykatës së Apelit, të hënën, më 22 gusht 2022, konfirmoi konstatimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake në lidhje me formën e aktakuzës dhe hodhi poshtë kundërshtimet e ngritura prej tre të akuzuarve.

Një prej kundërshtimeve të ngritura prej tre të akuzuarve ishte në lidhje me redaktimet në Aktakuzë. Paneli i Apelit, pranoi ndikimin e mundshëm që redaktimet në Aktakuzë mund të kenë ndaj aftësisë së përgjithshme të të akuzuarve që të përgatisin mbrojtje adekuate. Megjithatë, Paneli i Apelit konstatoi se prania e redaktimeve nuk përbën mangësi në formën e Aktakuzës dhe gjykoji se vlerësimi i ndikimit të këtyre redaktimeve, nëse ka, është i parakohshëm në këtë fazë.

Gjykatësit e Panelit të Apelit gjithashtu konstatuan se Aktakuza i përshkruan kontributet e pretenduara të të akuzuarve në ndërmarrjen kriminale të përbashkët dhe si ndihmues dhe inkurajues, me qartësi dhe konkretësi të mjaftueshme. Paneli i Apelit gjithashtu arriti në përfundimin se Aktakuza paraqet me qartësi dhe konkretësi të mjaftueshme faktet mbi të cilat mbështeten akuzat, përfshirë në lidhje me përgjegjësinë eprore.

Të hënën, më 22 gusht Paneli i Gjykatës së Apelit, në një vendim tjetër, hodhi poshtë apelin e Hashim Thaçit kundër vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake për paraburgimin. Paneli i Apelit, konfirmoi konstatimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake se masa të tjera nuk do të pakësonin mjaftueshëm rreziqet e identifikuara për pengim të ecurisë së procesit ose kryerje të krimeve të tjera.





**Informim javor për median  
Dhoma dhe Zyra Administrative**

N°30/2022

Hagë, 25/08/2022

Gjykatësi i Procedurës Paraprake në këtë çështje gjithashtu lëshoi vendim të martën, më 23 gusht, në të cilin urdhëroi Prokurorinë që të rishikojë klasifikimin e provave të nxjerra dhe të parashtrijë, deri më 4 nëntor, një listë të provave që mund të klasifikohen si publike, një listë të provave që duhet të mbeten konfidenciale deri në gjykim dhe një listë të provave që duhet të mbeten konfidenciale gjatë gjithë procesit.

Të hënën, më 22 gusht, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, hodhi poshtë kërkesën referuese të z. Pjetër Shala, në të cilin ai ngriti disa kundërshtime në lidhje me drejtësinë e procesit.

Paneli konstatoi se kërkesa referuese ishte e parakohshme në këtë fazë të procesit dhe rrjedhimisht e hodhi poshtë si të papranueshme. Konkretisht, Paneli gjykoj se rezultati i procesit mund të jetë i rëndësishëm në përcaktimin nëse z. Shala mund të pretendojë se është viktimë e shkeljeve të pretenduara të së drejtës së tij për një gjykim të drejtë. Paneli gjithashtu tha se ky vendim nuk e ndalon zotin Shala që të paraqesë ankesa në lidhje me drejtësinë e procesit kundër tij gjatë fazave të ardhshme të procesit. Versionin e redaktuar publik të Panelit të Gjykatës Kushtetuese mund ta gjeni në faqen e internetit të DHSK-së.

Z. Guçati, këtë javë dorëzoi dosjen e apelit kundër aktgjykimit të shpallur më 18 maj të këtij viti. Versionin e redaktuar publik të dosjes së apelit mund ta gjeni në faqen e internetit të DHSK-së.

Deklaratat përmbyllëse në çështjen gjyqësore *Salih Mustafa* janë caktuar për 13-15 shtator. Në parashtrimet e dorëzuara këtë javë, si Prokuroria ashtu dhe Mbrojtja njoftuan se ata vlerësojnë se deklaratat e tyre përmbyllëse do të zgjasin një ditë. Mbrojtja e viktimave vlerësoi se deklarata e saj përmbyllëse nuk do të zgjasë më shumë se dy orë.

**Pyetje nga gazetarët**

Nuk pati pyetje.

